



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/102
Datë: 07.05.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen procesverbalet nga mbledhjet 93 dhe 94 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/102
Datë: 07.05.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Rregullores nr. 26/2012 të Punës së Komisionit Qeveritar për të Drejtat e Ish të burgosurve, të Ish të Dënuarve e të Ish të Përndjekurve Politikë, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. I vazhdohet mandati edhe për një (1) vit Komisionit Qeveritar për Njohjen e Statusit të Ish të Dënuarve dhe të ish të Përndjekurve Politikë, në këtë përbërje:
 - 1.1. Rrahim Rama, Ministria e Drejtësisë;
 - 1.2. Sami Kurteshi, Kuvendi i Kosovës, gjegjësisht Komisioni Përkatës;
 - 1.3. Isak Shabani, Ministria e Shëndetësisë;
 - 1.4. Berat Luzha, Shoqata e ish të Burgosurve Politikë të Kosovës;
 - 1.5. Defrim Rifaj, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale;
 - 1.6. Një përfaqësues nga Shoqata e Juristëve të Kosovës.
2. Obligohet Komisioni nga pika 1. e këtij vendimi që të veprojë në përputhje me Ligjin Nr. 03/L-95 për të Drejtat e Ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë, me Rregulloren Nr. 26/2012 të Punës së Komisionit Qeveritar për të Drejtat e Ish të burgosurve, të Ish të Dënuarve e të Ish të Përndjekurve Politikë si dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/102
Datë: 07.05.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar propozimin e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, me nr. prot. 3563, datë 02.05.2019, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndalohet përkohësisht eksporti i masës drusore si lëndë e pa përpunuar nga Kosova në drejtim të vendeve tjera, për arsye të dëmtimit në sektorin e përpunimit të drurit në vendin tonë.
2. Obligohet Ministria e Financave, Dogana e Kosovës për zbatimin e këtij vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Dogana e Kosovës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/102
Datë: 07.05.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 29 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për ndarjen e mjeteve në shumë prej 57,944.38 € (pesëdhjeteshtatë mijë e nëntëqindëdyzetekatër euro e tridhjetetë cent) për pagesën e punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta në rezidencën presidenciale "Ibrahim Rugova".
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara me kod 232 nën-programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria e shpenzimeve të rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në nën programin Administrata Qendrore me kod 11307, në kategorinë e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/102
Datë: 07.05.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësim të Komunës së Istogut për interes publik i objekteve të vjetëruara të cilat janë nën menaxhimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) e të cilat gjenden në parcelat Nr. 1791-2 dhe 1792-0 pronë e Komunës së Istogut, të cilat preken nga realizimi i projektit "Rregullimi i Qendrës së Qytetit në Istog", konform Planit Zhvillimor Komunal 2018-2026, sipas tabelës pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Obligohet Agjencia Kosovare e Privatizimit ta largoj nga shtija e aseteve në likuidim (objekti restaurant Koreniku) që gjendet në parcelat Nr.1791-2 dhe 1792-0 pronë e Komunës së Istogut.
3. Vlera e kompensimit të objekteve të vjetëruara do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
4. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Komuna e Istogut, Ministria e Financave dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP).
5. Kompensimi i vlerës së objekteve të vjetëruara, shpenzimet e procedurës së shpronësimit dhe vlerësimit do të bëhen nga Komuna e Istogut në koordinim me Ministrinë e Financave dhe Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), konform legjislacionit në fuqi.
6. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/102
Datë: 07.05.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Republika e Kosovës dhe Ministrisë së Mjedisit Ruajtjes së Natyrës dhe Sigurisë Bërthamore - Republika Federale e Gjermanisë për miratimin në parim të Nismës për Marrëveshjen dy palëshe për qarkullimin ndërkufitar të mbeturinave respektivisht eksportin dhe importin e mbeturinave.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/102
Datë: 07.05.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Republika e Kosovës dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Energjisë - Republika e Kroacisë për miratimin në parim të Nismës për Marrëveshjen dy palëshe për qarkullimin ndërkufitar të mbeturinave respektivisht eksportin dhe importin e mbeturinave.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 08/102
Datë: 07.05.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti: *“Aplikimi për vende pune nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, që posedojnë diploma të lëshuara nga institucionet paralele arsimore në Republikën e Kosovës, ku zhvillohet mësimi në gjuhën serbe”*.
2. Obligohen Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, dhe institucionet tjera kompetente të vazhdojnë punën sipas opsionit dhe afatit kohor të propozuara në Koncept Dokumentin, sipas pikës 1. të këtij Vendimi.
3. Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit, në bashkëpunim me Komisionin për Verifikimin e Diplomave dhe Sekretariatit Koordinues të Qeverisë, që të përgatisë ndryshimet dhe plotësimet në Rregulloren (QRK)-Nr. 21/2015, sipas opsionit të propozuar në Koncept Dokumentin, sipas pikës 1. të këtij Vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/102

Datë: 07.05.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Jo-formale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2019-2023 dhe Plani i Veprimit 2019-2021.
2. Obligohet Grupi Punues Qeveritar për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/102
Datë: 07.05.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, duke shqyrtuar propozimin e Ministrisë së Administratës Publike, me nr. prot. 1548, datë 03.05.2019, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Z. Drin Haraçia, emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë 3 (tre) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi i kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/102
Datë: 07.05.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr. 04/L-237 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-068 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjit Nr. 05/L-092 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 dhe Ligjin Nr. 05/L-068, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Rekomandimi i Komitetit Drejtues (KDP) të Asistencës Teknike Energjia nga Linjiti Nr. prot. 1024 datë 03.05.2019, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 7 maj 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Të iniciohen procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit të kontratës për shërbime këshillimore juridike, për nevoja të Termocentralit „Kosova e Re“.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë dhe të njoftojë KRPP-në, nga data e marrjes së vendimit me të dhëna në lidhje me identifikimin e prokurimit dhe arsyetimin ligjor në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë